



Raport nga Konferenca Rajonale

Përfshirja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe në aktivitetet sociale

Koha / Vendi:

5 Dhjetor 2012 / Prishtinë

Organizuar nga:

Asociacioni i Komunave të Kosovës

Në bashkëpunim me:

GiZ/EDYK- Kosova

AGJENDA

10.00-10.40	Hapja e takimit (Moderuar nga z.Sazan Ibrahim) Z.Pal Lekaj, anëtar i Bordit të AKK-së Znj. Teuta Haxhiu, Anëtare e Komisionit Parlamentar për Rini Znj. Ganimete Musliu, Kryesuese e Grupit Joformal Parlamentar për Rini Z. James Macbeth, Drejtues i GiZ-it –Kosovë
10.40-11.15	Z. Haver Husaj, Kryesues i Komisionit të AKK-së për Rini (Legjislacioni i Kosovës në lidhje me të rinjtë, Aktivitetet rinore në Kosovë, KVRL) - Diskutime
11.15-11.55	Përfaqësuesi nga Sllovenia (Legjislacioni i Sllovenisë në lidhje me të rinjtë, Aktivitetet rinore në Slloveni, Pjesëmarrja e të rinjve) - Diskutime
11.55-12.30	Përfaqësuesi nga Shqipëria (Legjislacioni i Shqipërisë në lidhje me të rinjtë, Aktivitetet rinore në Shqipëri, Pjesëmarrja e të rinjve) - Diskutime
12.30-13.30	Pauza e drekës
13.30-14.05	Përfaqësuesi nga Bullgaria (Legjislacioni i Bullgarisë në lidhje me të rinjtë, Aktivitetet rinore në Bullgari, Pjesëmarrja e të rinjve) - Diskutime
14.05-14.40	Përfaqësuesi nga Kroacia (Legjislacioni i Kroacisë në lidhje me të rinjtë, Aktivitetet rinore në Kroaci, Pjesëmarrja e të rinjve) - Diskutime
15.00-16.00	Konkluzionet dhe Rekomandimet

Qëllimi i konferencës ishte: Diskutim mbi implementimin e infrastrukturës ligjore për rini, Diskutim mbi marrëdhënien ndërmjet nivelit qendror dhe lokal që ndikojnë në sektorin e të rinjve, Buxheti për rini, Puna e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL).

Pjesëmarrës në Konferencë ishin: Drejtorët komunal për Rini dhe Sport; Zyrtarët komunal për Rini; Anëtarët e Komisionit Parlamentar për Çështje Rinore; Anëtarët e Bordit të Grupit Joformal për Rini në Parlamentin e Republikës së Kosovës; Kryesuesit e Këshillave Rinor komunal dhe të Qendrave Rinore; Komuniteti i partnerëve ndërkombëtar që ndihmojnë në zhvillimin e sektorit të Rinisë në Republikën e Kosovës.

FJALIMET KRYESORE

Z.Pal Lekaj, anëtar i Bordit të AKK-së

Kam nderin që në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës të ju dëshiroj mirëseardhje në konferencën rajonale mbi përfshirjen e të Rinjve në proceset e vendim-marrjes dhe aktiviteteteve sociale

Autoritetet lokale duke qenë autoritetet më të afërta me të rinjtë, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje. Duke vepruar kështu, autoritetet lokale mund të sigurojnë që të rinjtë jo vetëm të dëgjojnë dhe mësojnë për pjesëmarrje aktive në vendim-marrje por

për më tepër të kenë rast që t'i ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat dalin nga Ligjet e Republikës së Kosovës. Megjithatë, pjesëmarrja e të rinjve nuk ka të bëjë vetëm me krijimin e qytetarëve aktiv ose me ndërtimin e demokracisë për të ardhmen. Është jetike që, nëse duam që pjesëmarrja të ketë kuptim për të rinjtë, ata të mund të ndikojnë dhe të mund t'u japin formë vendimeve dhe veprimeve në kohën kur ata janë të rinj e jo vetëm në një fazë të mëvonshme të jetës.

Duke u nisur nga fakti se rinia përbën rreth 60% të popullatës dhe se është kjo rinia nga e cila varet e ardhmja e Kosovës, AKK-ja vlerëson se është koha që, brenda mundësive, të bëhet një përpjekje shtesë për të ndarë fonde edhe më të mëdha për këtë sferë. Është fakt se megjithëse shumica e popullatës është nën 36 vjeç, rinia ndoshta edhe nuk është e përfaqësuar në të gjitha fushat e jetës publike. Për më tepër, nevojat e rinisë në përgjithësi dhe sigurimi se rinia ka kujdesin dhe qasjen në shërbimet publike janë të një rëndësie të dorës së parë.

Përfshirja e komunave është vendimtare pasi që ato janë pjesa e qeverisë që është më afër qytetarit. Strategjitë dhe politikat e reja përfshirëse, të cilat fuqizojnë përkushtimin e vërtetë të komunave, do të duhet të zbatohen për të trajtuar nevojat e rinisë në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Megjithatë, që kjo të jetë e efektshme autoritetet lokale do të duhet të punojnë shumë ngushtë me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Për më tepër, do të duhet të ndahen më shumë burime financiare nga niveli qendror.

Veprimtaritë e organizuara të të rinjve janë shumë të kufizuara dhe mungojnë veçanërisht mjediset sportive, të tilla si fushat sportive dhe sallat e sportit. Veprimtaritë janë shumë të kufizuara gjë që është në kontrast me grupet rinore shumë të motivuara nëpër komuna. Të rinjtë kanë shumë ide por kufizimet buxhetore së bashku, në disa raste me infrastrukturën jo të mirë paraqesin një pengesë për zhvillimin e sektorit rinor. Komunitat rekomandojnë se çdo komunë duhet të ketë si minimum: një sallë sporti, një qendër rinore dhe një qendër kulture. Komunitat kërkojnë nga Ministria që t'i mbështesë këto nisma. Komunitat do të ofronin hapësirën për ndërtimin e secilës nga këto qendra.

Sa i përket pjesëmarrjes së rinisë në proceset e vendim-marrjes, të rinjtë duhet të konsultohen më shumë lidhur me çështjet komunale që do të ndikojnë në jetën dhe



Përfshirja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe në aktivitetet sociale

të ardhmen e tyre. Të rinjtë ankohen se ata që marrin vendimet lidhur me rininë janë shumica persona në moshë të rritur të cilët, edhe pse me qëllim të mirë, marrin vendime bazuar në përshtypjet e tyre për situatën dhe nevojat e rinisë dhe nganjëherë kjo përshtypje nuk përputhet me realitetin. Prandaj, theksi duhet të vihet më shumë në autorizimin e këtyre grupeve dhe në tërheqjen e tyre për të marrë pjesë në jetën publike.

Znj. Teuta Haxhiu – Anëtare e Komisionit Parlamentar për Rini

Kjo Konferencë është shumë e mirëseardhur dhe nga këtu Komisionit zotohet se do të jetë përkrah tyre me adresimin e gjitha kërkesave, iniciativave dhe ideve që vijnë tek ne duke filluar nga ndarja e drejtë buxhetore për rini nëpër komuna deri tek ndikimi në fuqizimin e mekanizmave për avancimin e aktiviteteve rinore.



Znj. Ganimete Musliu, Kryesuese e Grupit Joformal Parlamentar për Rini



Grupi Joformal Parlamentar për Rini u formua në mandatin e kaluar dhe nga gjashtë deputet tash kemi 26 deputet në moshën 30 vjeçare. Nga angazhimi ynë kemi inicuar Ligjin për Rini dhe nga aktivitete tona ka pasur përmirësim në rolin dhe kyqjen më të madhe të të rinjve në proceset vendimmarrëse për fuqizimin e rolit të tyre. Ky angazhim përfshin edhe përfshirjen tonë edhe jashtë zyreve të Kuvendit të Kosovës. Tani kemi filluar amandamentimin e Ligjit për Rini dhe me këtë rast falenderojmë kryetarët e komunave për bashkëpunim. Kemi marrë iniciativën për

Ligjin për mbrojtjen e të të drejtave të fëmijëve dhe këtu falenderojmë GiZ-in për mbështetjen e madhe në këtë drejtim.

Z. Guenter Gryzbek – Udhëheqës i Programit për Rini në GiZ

Çdo gjë po sillet rreth buxhetit. Me të drejtë. Por ne së bashku me AKK-në, Komunitat dhe Grupin Joformal Parlamentar për Rini kemi punuar me muaj të tërë në projekt ligjin për mbrojtjen e të rinjve. Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në këtë ligj do të ketë edhe implikime buxhetore. Aktualisht kemi 16 ligje dhe rregullore për mbrojtjen e fëmijëve dhe rinië dhe atë në shtatë ministri dhe ka problem zbatimi i tyre për mungesë buxheti.



PREZANTIMET

Z. Aver Husaj, Kryesues i Komisionit të AKK-së për Rini

Z.Husaj u përqëndrua në legjislacionin e Rinisë në Kosovë i cili përcakton përgjegjësitë themelore për fuqizimin e sektorit rinor në Republikën e Kosovës dhe përkrahjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje si dhe përgjegjësitë e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale ndaj të rinjve dhe organizatave rinore në fushat përkatëse të rregulluara me këtë ligj.

Ai prezantoi funksionimin, organizimin dhe pikëpamjet mbi Këshillin Qendror të Veprimit Rinor, Këshillat e Veprimit Rinor Lokal (KVRL), Qendrat Rinore dhe aktivitetet e tyre. Poashtu z.Aver Husaj paraqiti edhe organizimin e Komisionit për Rininë në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës i cili ka për qëllim të shqyrtoj çështje specifike që kanë të bëjnë me fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në nivel komunal. Ai shtoi se bazuar në planet e veprimit të cilat po aprovohen edhe nga Kuvendet e Komunave, ato marrin edhe obligime financiare bazuar në to, siç janë manifestimet e ndryshme kulturore si dhe shkëmbime kulturore rinore. Ndër aktivitetet e komunave janë ato për mbrojtjen e ambientit, pastrim të parqeve, pyjeve, lumenjve, të ruajtjes së trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me institute rajonale për mbrojtjen e monumenteve, gara sportive, si dhe trajnime dhe kurse të ndryshme.

Znj. Barbara Horvat – Asociacioni i Komunave dhe Qyteteve të Sllovenisë

Znj.Horvat prezantoi legjislacionin në lidhje me rininë në Republikën e Sllovenisë dhe rregullat mbi zbatimin e dispozitave të akteve mbi rininë. Rinia vertikalisht është e organizuar në tek Zyra për Rini e Republikës së Sllovenisë si pjesë e Ministrisë për Arsim, Kulturë, Shkencë dhe Sport me përbërje të përfaqësuesëve të sektorit qeveritar dhe jo-qeveritar. Interesi publik në sektorin e rinisë është e ndërlikur me Programin Kombëtar për Rini i cili përcakton prioritetet dhe masat.

Dukle folur rreth asaj se çfarë është një qendër rinore në Slloveni përfaqësuesi nga Sllovenia shtoi se është një organizëm ligjor (Asociacioni - 45 %, Institucionet Private - 13 % dhe Institucionet Publike - 42 %) që ofron aktivitete të miratuara nga qeveria lokale ose komunat, mundëson një program të hapur (në 7 fusha të ndryshme) dhe siguron strukturën organizative që mundëson procesin demokratik dhe koordinimin e zbatimit të programit të planifikuar

Tek qasja ndërsektoriale aktivitetet organizohen me nashkëpunimin ndër-gjeneratave (e mbështetur nga programet e BE-së, veprime të udhëhequra nga Ministria çështjeve Familjare dhe Sociale), Qendra Multimediale (ofron hapësirë për grupe rinore muzikore, koordinator të e-pikave në qytete...) (veprime të udhëhequra dhe të mbështetura nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës) dhe Inkubatori i Ndërmarrësisë (ofron ndihmë dhe mbështetje për ndërmarrësit për të filluar biznesin e tyre të parë).



Z.Artan Pogoni – Drejtor për Rini dhe Sport në Bashkinë e Tiranës

Z.Pogoni pasi prezantoi legjislacionin e organizimit të rinisë në Shqipëri tha se në Shqipëri funksionojnë rreth 80 shoqata apo organizata rinore, të cilat drejtohen apo aderojnë në Keshillin Rinor Shqiptar. Ndërkohë Ministria e Turizmit , Kulturës Rinisë e Sporteve ka hartuar Strategjinë për Rininë e cila synon krijimin e një mjedisi mundësues që siguron pjesëmarrjen e të rinjve në formulimin e politikave dhe procesin e vendimmarrjes në nivel kombëtar. Në Shqipëri, rinia duke qenë një prej pasurive më të mëdha të këtij vendi (afro 70% e popullsisë është nën moshën 30 vjeç), nga ana e institucioneve rinia shihet me syrin e partnerit të vërtetë e të denjë për qeverisje të mirë e të gjithanshme.

Në shumë Bashki të Shqipërisë janë krijuar Qendrat Rinore të cilat përfaqësojnë interesat rinore dhe problemet kryesore të organizatave duke punuar me institucionet politike, parlamentin, qeverinë, organizatat dhe grupet e interesit në Shqipëri dhe jashtë saj. Qëllimi i tyre është edhe të zhvillojnë marrëdhëniet ndërkombëtare që kanë si fokus njohjen, bashkëpunimin, promovimin dhe zhvillimin e tyre në botën e të rinjve si dhe të promovojnë dhe implementojnë aksione, aktivitete dhe takime të përbashkëta me organizata të ndryshme në fushën e edukimit dhe rritjes së kapaciteteve të të rinjve.

Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë prej një viti dhe nismën për paisjen e Studentëve me Kartën Bashkiake të Studentit e cila sot është një realitet dhe ndihmesë shumë e madhe me lehtësime të ndryshme për të rinjtë student që nga kompanitë publike lokale deri tek ato private mbi bazën e një marrëveshje partneriteti.

Znj. Ginka Tchavdarova – Drejtore Ekzekutive e Asociacionit Kombëtar të Komunave në Republikën e Bullgarisë

Znj.Tchavdarova foli për kornizën e Bashkimit Evropian për Rini, politikat Kombëtare për Rini, politikat Lokale për Rini, format e përfshirjes e të rinjve në nivel lokal si dhe aktet Evropiane dhe Programet për të rinjtë. Ndër aktet dhe politikat funksionale

Përfshirja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe në aktivitetet sociale

në Bullgari për rini ajo përmendi Aktin e Edukatës Fizike dhe Sporteve, Strategjinë për Politikën Kombëtare të Rinisë, Programet Vjetore për Aktivitetet Rinore etj. Ndër problemet dhe sfidat e rinisë ajo përmendi ndryshimet e vlerave të jetës, ndryshimet e filozofisë së jetës dhe modelet e sjelljeve, tendencat e individualizimit dhe negativizmit, konsumizmi dhe stili "Unë i dua të gjitha këtu dhe tani!" , "Zhytjet" në botën virtuale, refuzimin e martesës tradicionale dhe shlyerja e lindjes së fëmijëve. Pastaj mospërputhje me realitetin ekonomik: papunësia e të rinjve, presioni për migrimin e brendshëm - nga qytetet e vogla (ose fshatra) në qytetet e mëdha apo kryeqytet dhe migrimet e jashtme - emigracioni masiv në vendet e tjera në kërkim për një jetë më të mirë

Politikat kombëtare për të rinjtë e Bullgarisë janë të përfshira me masat si ato për stimulimin aktiviteteve edukative si pajisje të TI-së për shkollat, bursa për çmime për nxënësit me të ardhura të ulëta, nxënësit me aftësi të kufizuara dhe fëmijët pa prindër, kredi me normë të ulët për arsimin e lartë, pastaj trajnime në gjuhë të huaj, aftësi për TI, aftësi për biznes dhe administratë, arsimin profesional dhe kualifikim-sistemi voucher.

Si përfundim ajo potencoi programe të ndryshme kombëtare pa dispozita të burimeve, të rinjtë janë të papërfaqësuar në pozita politike në nivel lokal, problemet me papunësinë dhe kualifikimin e të rinjve, rorma kryesore e pjesëmarrjes së të rinjve në nivel lokal - këshillat rinore dhe parlamentet, problemi më i vështirë - tejkalimi i mungesës së motivimit tek të rinjtë, shumica e të rinjve lënë mënjanë politikën si veprimtari shoqërore dhe pse mbi 40% e komunave të kanë zbatuar politikat për të rinjtë.

Z.Anamarija Soco – Koordinatore e Rrjetit Rinor të Kroacisë

Znj.Soco në prezantimin e sektorit të rinisë në Republikën e Kroacisë foli për realitetet rinore dhe angazhimin dhe punën e të rinjëve. Ajo tha se aktivitetet rinore kanë filluar si rini e fuqishme në organizimet studentore. Origjina e tyre është në në lëvizjen e paqes në vitet 90-ta ndërsa organizimet më të fuqishme në vitim 2000 ku ndikimet ishin të mëdha në zhvillimet politike dhe duke ju përgjigjur nevojave lokale.

Aktualisht fushat e ndryshme të veprimit sot të rinisë janë informim, koha e lirë, ekologjia, kultura, arsimit jo-formal, shkëmbimi... Ndërsa në përgjigje të problemeve të rëndësishme është papunësia, arsimimi i cilësuar, pjesëmarrja, përjashtimi social. Tek strukturat e organizuara të rinisë sot kemi Qendrat Rinore, Klubet Rinore, Qendrat informuese rajonale/lokale.

Ndërsa sfidat prekin mungesën e definicioneve dhe mungesën e mbështetjes, nevoja për më shumë investime nga komunitetet lokale. Ndërsa kryeqyteti ka Qendrën e Zagrebit për rini dhe kulturë të pavarur e cila është një qendër multi-lokacionale dhe multi-funksionale ku sjellin rininë së bashku me kulturat e tyre.

